R E P U B L I K A   E   K O S O V Ë S
/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO/
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICI/ BASIC COURT IN MITROVICA

C.nr. 177/2012

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesit; . , nga ., te cilin e perfaqson Avokat . nga . sipase autorizimit me shkrim, kunder te paditures; Komuna e . te cilen e perfaqson Avikati Publik Komunal; . ., baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e kontestit;1.250,oo Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.26.12. 2013 jep kete;

## A K T G J Y K I M

I- **APROVOHET** kerkespadia e paditesit; , nga dhe **VERTETOHET** se paditesit eshte pronar i baneses e cila perbehet prej 2- dhomave, dhe 1- terace me siperfaqe prej **49m2**, me masa dhe kufije te shenuara ne skicen e terenit te ekspertizes, e cila gjendet ne , e mbi ndertuar ne pjesen e nderteses **P+4,** me nr. ., me kultur banesore –afariste ne vendin e qujtur Rr.". " nr. 14, e cila evidentohet ne emer te bashpronesise ne ndertese ne pjese te perbashketa- ZK

II - **Detyrohet** e paditura qe ti njohe kete te drejt paditesit dhe te lejoje regjistrimin e te njejtes ne emer te paditesit si pronar i kesaje banese ne afat prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

## A r s y e t i m

Paditesi ne padi si dhe ne seancat e mbajtura nepermjet te autorizuarit te tije ka theksuar; se i njejti me pelqimin e ' te banoreve te nderteses dhe me pelqimin e organit kompetent te ' Lokale "Qendra" ne . , ish Rr, ', tani . " " " nr. , qyshe ne vit. 1979 e ka ber ndertimin e nje objekti per banim me qellim qe te beje strehimin per familjen e tije 6-antarshe, nga se nuk ka pasur ndonje zgjidhje tjeter per banim..

Pase realizimit te ketije mbindertimi dhe vendosjes ne kete banese me familjen e tije , paditesi prane organit kompetent te paditures ka bere kerkese par marrjen e vendimit mbi shfrytzimin e baneses te cilin organi i atehershem kompetent i te paditures ia ka dhene., mirepo fatkeqsisht tani kete vendim nuk e posedon sepse i ka humbur me shume dokumente tjera per fakte te njohura- luftes ne Kosove , kur i jejti me dhune eshte detyruar te largohet nga banesa e tije nga forcat ushtarake dhe policore Serbe.

Duke pasur parasyshe faktin se paditesi eshte posedues i ligjshem dhe mirbesim i baneses lendore, ne baze te pelqimit te banorve te nderteses, pelqimit te organit kompetent, BL-Qendra, vendimit te paditures te vit 1980, ashtu qe paditesi e ka fituar te drejten e pronesise ne kete banese .

Ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Perfaqsuesi i te padituries ne pergjigjje te padise dhe kerkespadise te paditesit deklaroi; ngeli ne konsideraten e vendimmarrjes ne baze te rezultatit te provave

Shpenzimet e perocedures kontestmore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Kerkesen per pelqimin e banoreve per mbindertimin e baneses dt. 15.05.1979, vertetimin e te paditures nr. dt 20.07.1998, Faturen per nr. dhe skices dt. 10.10.1995, Faturat e per vit. , 94 dhe, 99 Faturat e per vit. 2002 dhe 2012, Ekspertizen e ekspertit gjeodet dt 19.12.2013, skicen e terenit dt 19.12.2013, Certifikaten e pronesise dt 19.12.2013, Proqesverbalin mbi kqyrje ne vend te kesaje gjykate C. nr/ 177/2012 dt 18.12.2013 dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga kerkesa e paditesit e sipercekur ,konstatohet se paditesi i eshte drejtuar . te banorve te nderteses tani lendore per dhenjene pelqimit per ndertimin e banese ne kulmin e kasaje ndertese , qka edhe i eshet dhene pelqimi.

Nga Ekspertiza e ekspertit gjeodet te sipercekur konstatohet se; ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon Drejtoria per Gjeodezi, Kataster dhe Prone ne , pase matjeve eshte konstatuar qe mbindertimi eshte bere ne pjesen , mbi objektin te cekur ne dispozitiv me siperfaqe 49m2. Mbindertimi perbehet prej 2- dhomave, 1- tarace me masa dhe kufinje te shenuara ne skicen e terenit qe eshte pjese e kesaje ekspertize.

Nga skica e terenit shifet[ vendi, shtrierja dhe siperfaqja e baneses tani lendore.

Nga procesverbali i kqyrjes ne vend i kesaj gjykate i lartcekur, gjyqtari me vrojtim te drejperdrejt ne vend ka konstatuar se ne objektin-ndertesen ne fjale P+4, ,gjendet banesa e paditesit e cila perbehet nga 2-dhoma dhe 1- terac, ne siperfaqe 49m2.

Nga Certifikata e sipercekur konstatohet se njesia katastrale
, evidentohet ne emer te bashpronesine ne ndertese ZK-
Nga vertetimi i te paditures i sipercekur , vertetohet se paditesi ne bashksi familjare ka 4-antar.
Nga Faturat e Kekut dhe , te sipercekura konstatohet se paditesit i jane ofruar sherbime nga keto kompani, ne adresen ku gjendet tani banesa lendore.

Nga provat e sipercekura gjykata erdhi ne perfundim se paditesi me dt. 15.05.1979 me kerkese iu eshte drejtuar banorve te nderteses e cekur qe ti japin pelqimin per ndertimin e nje banese ne kulmin e nderteses ekzistuese i cili pelqim eshte marr nga banoret e saje.

Paditesi me mjete vetanake ka kryer mbindertimin e baneses tani lendore dhe pase perfundimit paditesi me antaret e familjes eshte vendosur ne te dhe ka qendruar atu qe nga viti 1979 gjer me tani. Qka vertetohet nga vertetimi i sipercekur i te paditures mbi antaret e bashsise familjare te tani paditesit si dhe faturat si ajo; per numrin e shtepis, dhe skices, faturat e ... si dhe te sipercekura,

Ne nje gjendje te ketill faktike te vertetuar me larte, gjykata kerkespadin e paditesit e aprovoi ne tersi si te bazuar, konform nen. 40 te Ligjit per pronsin dhe te drejtat te tjera sendore.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti mbindertimit te baneses lendore paditesi e ka ne shfrytzim dhe disponim te lire kete palujtshmeri dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i kesaje palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesi kete palujtsheri e ka ndertuar ne baze te pelqimeve perkatese dhe te dokumentacionit gjegjes te sipercekur te lshuar nga organet kompetente .

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekziston sepse paditesi e ka ne shfrytzim qe nga viti 1979.

Gjithashtu nga momenti i ndertimit [mbindertimit], paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje banese gjer me tani dhe se e paditura edhepse e ka ditur per kete mbindertim, asnjeher nuk ka ngritur ndonje kerkese apo kundershtim lidhur me banesen tani lendore. Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne menyre ; derivative- me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, bazohet ne dispoziten e nen. 450 te LPK.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**
C nr177/2012 dt 26.12.2013.

**G j y q t a r i,**
Ragip Kadriu

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves ne Prishtine e permes kesaje gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
MITROVICË / MITROVICA
Më / Dana 16 ... 20 14